



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:099813

Datë: 07.06.2021

Numri i dokumentit: 01856735

P.nr.928/13

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Bekim Veliqi, me anëtarët e trupit gjykues-gjyqtarët Nurije Shala dhe Izet Gërguri, procesmbajtës Endrit Hajrizaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.U nga Komuna e Mitrovicës për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPRK-së, e rikualifikuar në veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.47/2013, e dt.27.09.2013, të cilën Aktakuzë e ka përfaqësuar Prokurori i Shtetit Njazi Rexha, ka prezantuar i akuzuari A.U dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av.Agim Lushta, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor e cila ka qenë e hapur dhe publike në respektim të masave anti Covid-19, në bazë të nenit 359, 360, 361, 362, 366 të KPP-së, me dt.20.05.2021, është marrë dhe shpallur publikisht aktgjykimi, ndërsa aktgjykimi është përpiluar me dt.07.06.2021;

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.U, nga i ati M., e ëma M., e gjinisë H., i lindur me dt., në Mitrovicë ku dhe jeton në rr.“...”, me nr.personal ..., i martuar, ka të kryer shkollën fillore, i punësuar në fushën e bujqësisë, i gjendjes së mesme ekonomike, ka qenë nën masën e paraburgimit respektivisht arrestit shtëpiak nga dt.08.04.2013 e deri me dt.05.09.2013, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Gjatë muajit mars-prill 2013, pa autorizim është furnizuar me substancë narkotike në lagjen e “Boshnjakëve” në Mitrovicë, më pas j’u ka shitur L.P e B.J marihuanë me çmimin prej 5 euro për qese, ashtu që me dt.08.04.2013 Policia sipas Urdhërkontrollit UGJK nr.34/13 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda, ka bërë kontrollin e shtëpisë dhe lokaleve tjera përcjellëse të akuzuarit në rr.“...” në Mitrovicë, e gjatë kontrollit në dhomën e fjetjes së të akuzuarit nën krevat ka gjetur dhe konfiskuar pesë paketime me substancë narkotike-marihuanë pesha neto e përgjithshme 6.92 gram dhe 3 qese najlloni të zbrazëta për paketimin e substancës narkotike.

Me këtë ka kryer veprën penale *Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së.*

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 21, 41, 46, 50, 51, 52, 62, 69, 73, 74 të KPRK-së dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366 të KPP-së i

SHQIPTON

I. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 400€ (katërqind euro), i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, në të kundërtën në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në bazë të nenit 46 par.3 të KPRK-së, si dhe **DËNIM ME BURGIM** në kohë zgjatje prej dy (2) viteve i cili nuk do të ekzekutohet në afat prej dy (2) viteve, nëse i akuzuari gjatë kohë së verifikimit nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me burgim në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit respektivisht arrestit shtëpiak nga dt.08.04.2013 e deri me dt.05.09.2013.

II. Në mbështetje të nenit 69 par.1 të KPRK-së të akuzuarit i shqiptohet **DËNIM PLOTËSUES *Marrja e sendit*** dhe në mbështetje të nenit 273 par.5 të KPRK-së e lidhur me nenin 282 par.2 nën 2.4 të KPP-së **KONFISKOHET** substanca narkotike marihuanë në peshë neto të përgjithshme prej 6.92 gram, (sipas Raportit të Ekspertizës së Agjencisë së Kosovës për Forenzikë me nr. ref. AKF/2013-2234/2013-1797 e dt.18.07.2013), *substanca narkotike pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të shkatërrohet.*

III. Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale- paushallin gjyqësor në shumën prej 30€ (tridhjetë euro) si dhe 50€ (pesëdhjetë euro) në emër të fondit për kompenzimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

I. Aktakuza

Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur Aktakuzë PP.I.nr.47/2013, e dt.27.09.2013, kundër të akuzuarit A.U nga Komuna e Mitrovicë, për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPRK-së.

II. Rrjedha e procedurës

Në këtë çështje penale është caktuar seancën e shqyrtimi fillestar, ne te cilen seance ka prezentuar i akuzuari A.U dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av.Agim Lushta, në seancën e shqyrtimit fillestar i akuzuari është deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale sipas aktakuzës dhe i njëjti është njoftuar për të drejtat e tij në që brenda afatit prej 30 ditësh ka mundësin e parashtrimit të kërkesës për hüdhen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, janë ndërmarrë veprimet përkatëse juridike në këtë çështje, brenda afatit te përcaktuar pas mbajtjes se seancës fillestare nga mbrojtësi është parashtruar kundërshtim ndaj aktakuzës, Gjykata ka marre Aktvendim duke e refuzuar te pabazuar kundërshtimin e te akuzuarit te parashtraur nga mbrojtësi për hedhjen e aktakuzës, nuk është parashtruar ankese ndaj aktvendimit, procedura ka vazhduar me caktimin e seancave te shqyrtimit gjyqësor për dt.11.04.2019, dt.13.01.2020, dt.19.02.2020, dt.13.03.2020, dt. 21.04.2020 e cila seancë nuk është mbajtur për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia Covid-19, dt.15.03.2021, dt.19.04.2021, dt.20.05.2021, ku me dt.20.05.2021 është bërë edhe shpallja publike e Aktgjykimit në prezencë të të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij ndërsa në mungesë të Prokurorit të Shtetit.

III. Pretendimet e palëve

III.1 Fjala përfundimtare e Prokurorit të Shtetit.

Prokurori i Shtetit gjatë këtij shqyrtim gjyqësor ka mbetur pranë akuzës, me një qëndrim të tillë ka mbetur edhe në **paraqitjen e fjalës përfundimtare**, duke theksuar se pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave vërtetohet se i akuzuari A.U ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet në aktakuzë, kjo gjendje faktike vërtetohet nga deklaratat e dëshmitarit L.P nga e cila rezulton se A.U e ka fqinjë, se me të njëjtin ka pasur kontakte të shpeshta telefonike lidhur me narkotikët dhe se me shokun e tij E. me automjetin e markës Pezho kanë shkuar tek i njëjti dhe kanë blerë qese me marihuanë me qmimin prej 5 euro, gjithashtu edhe dëshmitari B.J deklaron se A.U e ka fqinjë se me të njëjtin me shtëpi janë larg vetëm 200 metra, se prej tij ka blerë një qese me marihuanë me qmimin prej 5 euro dhe se së paku 4 herë ka blerë prej tij substancë narkotike, dhe të gjitha bisedat telefonike për narkotikët i ka zhvilluar pas orës 22:00 min., nga raporti i ekspertizës njësia e shkencave ligjore rezulton se është bërë ekzaminimi i substancës bimore me ngjyrë të gjelbërt, nga dëshmit 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5 dhe ka treguar se është prezent kanabisis marihuanan që përmbanë tetrahidrokanabinol, sipas karakteristikave moroflogjike dhe përbërjes kimike, rezulton se dëshmitë e cekura më lart përmbajnë kanabisë, që përmbanë tetrahidrokanabinol pesha neto e përgjithshme 6.92 gram, nga procesverbali mbi bastisjen e banesës dhe personave rezulton se gjatë bastisjes së shtëpisë së të akuzuarit në katin e dytë të shtëpisë, në dhomën e fjetjes, nën krevat është gjetur një qese me substancë narkotike dhe 3 qese të zbrasta që shërbejnë për paketimin e narkotikëve, po ashtu nga transkriptet nxjerr nga përgjimet ligjore rezulton se me dt.05.04.2013, në pra 02:13:22 rezulton se A.U ka biseduar në telefon me personin e panjohur i cili kërkon prej tij që të dal tek rruga, i telefonon se është në rrugë, ai insiston përsëri që të dal dhe të takohen para shtëpisë së A., po ashtu me dt.02.04.2013, rreth orës 22:18:42 bisedon me N/n personin i cili kërkon prej A. substancë narkotike, i përgjigjet se nuk mund ti jep të tërën se nuk është e tij, po ashtu nga përgjimet ligjore, rezulton se A.U ka pasur kontakte telefonike me I.Sh, dhe ka qenë ndërmjetësues mes i.Sh dhe V.M në lidhje me shitjen e narkotikëve, mbrojtja e të akuzuarit A.U se ka marrë pesqëshe prej shokëve të tij por që nuk ka blerë vetëm në formë të huazimit, është e pabzë, e pa argumentuar, e orientuar nga shmangia e përgjegjësisë penale dhe në kundërshtim të plotë me deklaratat e dëshmitarëve L.P dhe B.J, andaj i propozoj gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor për veprën e kryer penale dhe me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me ligj.

III.2 Fjala përfundimtare e mbrojtësit të të akuzuarit A.U, av.Agim Lushta, i cili në fjalën përfundimtare ka deklaruar se duke u nisur nga deklaratat e dhënë në polici dhe gjendja faktike e vërtetuar në shqyrtimet gjyqësore, e lus gjykatën që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh faktin se vepra penale ka ndodhur para 8 viteve, se që nga ajo kohë klienti im më nuk është merr me posedimin e narkotikëve, konsideroj se kualifikimin që e ka bërë Prokuroria të bëjë rikualifikim ashtu që klienti im të dënohet për veprën penale të posedimit, me këtë rast i propozoj që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh faktin se klienti im më nuk ka përdorur narkotikë, është i moshës së re, i njëjti premtan se në të ardhmen sikurse gjerë me tani më nuk do të merret me këtë lloj veprimtari dhe me një dënim më të butë besoj që do të arrihet qëllimi i dënimit që i njëjti në të ardhmen mos të kryej vepra penale.

III.3 Fjala përfundimtare e paraqitur nga i akuzuari A.U, i cili ka deklaruar se mbështes deklarinimin e mbrojtësit tim, substancën narkotike e kam pasur vetëm për posedim dhe jo me qëllim të shitjes, kërkoj nga gjykata që të më liroj sepse tani jam në marëdhënie pune dhe nuk

merrem me substanca narkotike, është një kohë e gjatë që nga koha e veprës penale, kërkoj nga gjykata një dënim me kusht.

IV. Procedimi i dëshmitarëve

Prokuroria ka propozuar në Aktakuzë që në cilësinë e dëshmitarëve të dëgjohen L.P dhe B.J. Gjykata dëshmitarit L.P i ka dërguar ftesën për seancë në mënyrë të rregullt, i njëjti nuk ka prezentuar në seancë, andaj Gjykata ka lëshuar Urdhëresë me dt.02.03.2021, ku ka urdhëruar shoqërimin me forcë të dëshmitarit L.P, nga Raporti i Policisë i dt.15.03.2021, Gjykata është njoftuar se dëshmitari L.P nuk gjendet në Kosovë sipas familjarëve të tij, ai ka rreth 2 muaj që është në shtetin e Sllovenisë pa përcaktuar adresë të saktë të vendqëndrimit.

Prokurori i Shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt.20.05.2021, ka propozuar që të lexohet deklarata e dëshmitarit L.P e dhënë në Polici me dt.03.05.2013, lidhur me propozimin e Prokurorit të Shtetit, mbrojtësi i të akuzuarit ka deklaruar se nuk kam kundërshtime që të lexohet deklarata për shkak të bazës ligjore që e lejon një gjë të tillë edhe me arsyet e konstatuara në procesverbalet e seancave të tjera me qëllim të sigurimit të prezencës së tij në këtë çështje. I akuzuari ka deklaruar se nuk ka kundërshtime.

Trupi gjykuës ne mbështetje te nenit 338 par.1 nenpar.1.3 te KPP-es, ka marrë Aktvendim, duke aprovuar propozimin e Prokurorit të Shtetit dhe është lexuar Deklarata e dëshmitarit L.P e dhënë në Prokurori dt.02.05.2013, me dt.03.05.2013.

IV.1 Dëshmitari L.P në Deklaratën e dhënë në Polici me dt.03.05.2013, ka deklaruar se

ka përdorur numrin e telefonit ..., e njeh A.U pasi që e ka fqinjë pasi që ai jeton afër shtëpisë së tij, ka pasur kontakte telefonike me A. dhe kanë biseduar për “bari” që nënkupton marihuanën, sepse ka pirë dhe e kam marrur një qese nga A., marihuanën gjatë kohës së mbrëmjes ku ka shkuar për ta marrë marihuanën me një shokë me veturë të tij dhe me të kanë përdorur bashkë një cigare të marihuanës, ku për këtë qese të marihuanës ja ka japur A. të holla në shumë prej 5 euro, ka përdorur marihuanë një herë se bashku me A. dhe marihuanën e ka siguruar A..

IV.2 Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.20.05.2021 në cilësi të dëshmitarit është

dëgjuar B.J i cili ka deklaruar se e njeh A.U si fqinjë të tij, shtëpiat larg nga njëri tjetri i kanë përafërsisht rreth 200 metra, kanë konsumuar së bashku me A. substanca narkotike ndërsa tani nuk është përdorues i substancës narkotike, ka deklaruar se kanë biseduar me A. në telefon për substancë narkotike dhe se policia në momentin e marrjes së deklaratës i kanë prezentuar dokumentat për bisedat telefonike që i kanë pasur mirëpo nuk e ka ditur se tek kush është gjetur droga, ka deklaruar se është e vërtetë se prej A. ka blerë substancë narkotike me qese me marihuanë prej 1 deri 2 gram, ka deklaruar se vetëm një herë ka blerë substanca narkotike, kam biseduar me A. lidhur me cilësinë e substancës narkotike, nuk i kujtohet nëse ka dhënë një deklaratë në polici pasi që ka kaluar kohë e gjatë, nënshkrimi i dhënë në deklaratën në polici është i imi, nuk më kujtohet se çka kam deklaruar në atë deklaratë, marihuanën që e kam blerë e kam konsumuar vetëm, kur ka blerë A. marihuanë e kemi konsumuar së bashku.

V. Administrimi i provave materiale

Në seancën gjyqësore të dt.20.05.2021 janë administruar provat personale dhe ato materiale dhe atë: *Raporti i ekspertizës së nga Njësia e Shkencave Ligjore, Analiza Kimike-Agjencia e Kosovës për Forenzikë me nr.AKF/2013-2234/2-13-1797 i dt.18.07.2013, Procesverbali mbi bastisjen e banesës dhe personave i dt.08.04.2013, Lista e gjërave të konfiskuara me nr.2013-DHTN-81 e dt.08.04.2013, Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes me nr.2013-DHTN-81 i dt.08.04.2013, Pjesë të transkriptës nga përgjimi ligjor sipas Urdhëresës UGJK.nr.37/13,*

Fotodokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës-Fotoalbumi me nr.2013-DHNT-81 i dt.08.04.2013.

Prokurori i Shtetit, mbrojtësi dhe i akuzuari kanë deklaruar se nuk kanë vërejtje sa i përketë provave të cilat janë administruar, po ashtu kanë deklaruar se nuk kanë propozime të tjera sa i përketë procedurës për plotësimin e provave, ashtu siç konstatohet në procesverbal.

VI. Paraqitja e mbrojtjes nga i akuzuari A.U

I akuzuari A.U në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.20.05.2021, pasi që është njoftuar me të drejtat e tij në bazë të nenit 323 dhe 346 të KPP-së, ka deklaruar se pas konsultimit me mbrojtësin do të shfrytëzoj mundësinë që të mbrohem në heshtje dhe pas deklarimit të të akuzuarit, kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se e drejta për mbrojtje në heshtje është e drejtë ligjore e paraparë me nenin 346 par.1 të KPP-së.

VII. Gjetjet e Gjykatës dhe vlerësimi i provave

Pas procedimit të provave materiale dhe atyre personale në këtë shqyrtim gjyqësor, dëshmitareve të konstatuar si më lart, paraqitjes së fjalës përfundimtare nga palët, vlerësimi të tyre në lidhje me provat tjera Gjykata në mbështetje të nenit 361 par.2 të KPP-së, ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit, duke u provuar se në veprimet e të akuzuarit konsumohen elementet e veprës penale ***Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së***, me arsyet si më poshtë;

Faktet jokontestuese

Faktet në vijim nuk kanë qenë kontestuese:Tek i akuzuari A.U është gjetur substancë e dyshuar narkotike e mbështjellur në 5 qese najloni, 3 qese per pakteim te zbrazta, pas ekzaminimit laboratorik të substancës është konstatuar se kjo substancë përmbanë substancë naroktike Kanabis (Marihuanë) që përmbanë Tetrahidrokanabinol me peshe neto 6.92 gram, nuk është kontestuese se personave - deshmitareve L.P dhe B.J, i akuzuari ju ka ofruar dhe shitur substanca narkotike, kete fakt e vërtetojnë vete deshmitaret, siç konstatohet ne deklarata e deshmitareve te dhëne ne Polici, po ashtu kete fakt e vërteton edhe deshmitari B.J gjate seances se shqyrtimit gjyqesor te dt.20.05.2021, te cilët pohojnë faktin se kane blere substanc narkotike nga i akuzuari, po ashtu bazuar në provat që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor gjegjësisht nga Fotodokumentacioni-Fotoalbumi dt.08.04.2013, procesverbali mbi bastisjen e banesës dhe personave dt.08.04.2013, lista e gjerave te konfiskuara nga i akuzuari dt.08.04.2013, raporti i këqyrjes se vendit te ngajrrjes dt.08.04.2013, pjesa e transkriptit nga përgjimi i spas Urdhresse UGJK nr 37/12, Ekspertiza e Njësisë së Shkencave ligjore, Analiza Kimike-Raporti i Ekspertizës nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me nr.AKF/2013-2234/2-13-1797, dt.18.07.2013, që gjenden në shkresat e lëndës faktet e lart cekura nuk janë të kontestuara, te gjitha keto vërtetojnë elementet e vepres penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së.

Nga Fotodokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës shihet vendi shtëpia ku është gjetur substanca narkotike tek i akuzuari, substanca narkotike së bashku me qesen të vendosura në pesë qese të vogla, si dhe tri qese për paketim të zbrazta.

Nga Ekspertiza e Njësisë së Shkencave ligjore, Analiza Kimike-Raporti i Ekspertizës nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me nr. AKF/2013-2234/2-13-1797, dt.18.07.2013, e

vërteton faktin se substanca e gjetura tek i akuzuari përmbajnë substancë narkotike Kanabis Marihuanë me specifikat e cekura si më lart në këtë Aktgjykim.

Për Gjykatën, faktet e lart cekura nuk ishin kontestuar nga Prokurori i Shtetit, i akuzuari dhe as nga mbrojtësi, përveç kësaj këto fakte vërtetohen edhe nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor që janë pjesë e kësaj lënde dhe të gjitha këto vërtetojnë elementet e veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së.

VIII. Pretendimet e të akuzuarit dhe vlerësimi i Gjykatës lidhur me pretendimet e parashtruara në mbrojtjen e tij.

Deklarimi i të akuzuarit dhënë në fazën e procedurës hetimore dhe mbrojtja e tij me heshtje gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykatës një veprim i tillë i paraqitur nga i akuzuari, në konsulltim edhe me mbrojtësin, nuk i ka ofruar dëshmi për një gjendje tjetër faktike siç është e parashtruar nga Prokurori i Shtetit, mbrojtja e të akuzuarit e dhëne në Polici e vërteton veprimet inkriminuese në drejtim të veprës penale që akuzohet, ndërsa arsyet se e ka pasur vetëm në posedim substancën narkotike, e jo me qëllim të shitjes, janë pretendime plotësisht të pa bazuara dhe një mbrojtje e tillë e të akuzuarit bëhet vetëm me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale dhe është në kundërshtim me të gjitha provat e administruar gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor.

Në deklaratën e dhëne pranë Prokurorit të Shtetit dt.02.05.2013, në prezencë të mbrojtësit i akuzuari e pohon faktin në faqen 3, “ *ka ndodh që shokët me kanë thënë dhe i’u kam japur pesëshe si huazim por jo edhe shitje*”... ka shtuar se “ *..ka ndodhur që kur kam mbetur pa marihuane kam huazuar me shokë, unë kam marrë prej tyre e ata prej meje me qëllim që ma vonë të kompensohen por jo për shitje*”...

Gjykata në vlerësimin e mbrojtjes së të akuzuarit në deklarin e tij se;” *ka ndodh që shokët më kanë dhënë dhe iu kam japur pesëshe si huazim por jo edhe shitje*”... ka shtuar se “ *..ka ndodhur që kur kam mbetur pa marihuanë kam huazuar me shokë, unë kam marrë prej tyre e ata prej meje me qëllim që ma vonë të kompensohen por jo për shitje*”..., respektivisht mbrojtësit e cila mbrojtje është refuzuar e pabazuar me pretendimin e shmangies nga përgjegjësia penale dhe se deklarimi i të akuzuarit A.U, i cili nuk e mohon faktin se ka pasur në posedim substancë narkotike, por pretendimet se e ka pasur vetem për veten është i pabazuar, pasi që të kundërtën e vërtetojnë dëshmitarët B.J dhe L.P, po ashtu këtë fakt e vërteton edhe vet i akuzuari në deklaratën e dhënë gjatë fazës hetimore ku e pohon faktin se ju ka dhënë substancë narkotike personave – tani dëshmitarëve B.J dhe L.P, por arsyetohet se nuk ju ka shitur por vetëm ju ka huazuar, pretendimet e mbrojtësit dhe te akuzuarit janë të pa bazuar dhe në kundërshtim me provat e proceduara në këtë çështje penale të konstatuara si më lart.

Po ashtu është refuzuar i pa bazuar pretendimi i mbrojtësit të parashtruar në fjalën përfundimtare që të kemi rikuliaifikim në veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 të KPRK-së, me arsyet e cekura si më lart.

Gjykata vlerëson se provat e proceduara në këtë çështje janë në përputhshmëri me vendimin e marrë si në dispozitivin e këtij aktgjykim, të konstatuara nga deklarinet e dhëna dhe të gjitha këto deklarime të dhëna nga ana e dëshmitareve të proceduar në këtë çështje, administrimi provave, janë të qëndrueshme, andaj gjykata ka krijuar bindjen e plotë duke vendosur si në

dispozitiv të këtij aktgjykimi në vlerësimin e të gjitha rrethanave në mbështetje të provave personale dhe prova materiale se pa asnjë dyshim dhe në mënyrë bindëse për gjykatën vërtetohet se në veprimet e të akuzuarit janë konsumuar elementet e veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së

IX. Rikualifikimi i veprës penale

Pas analizimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, akuzës dhe përshkrimin faktit të dispozitivit të akuzës, Gjykata gjenë se përshkrimi faktik dhe veprimet inkriminuese të përshkruara në dispozitivin e aktakuzës përmbushen elementet, figura, objekti si dhe veprimet e kryerjes së veprës penale ***Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së.***

Sipas vlerësimit të Gjykatës, në rastin konkret **me qenë se nuk është përmbushur elementi i ndërmjetësimit në veprimet e të akuzuarit që kërkohet tek** vepra penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPRK-së, duke marrë për bazë rrethanat e konstatuara si më lart pas administrimit të provave, në vlerësim edhe me sasinë e substancës narkotike 6.92 gram cila është konfiskuar nga i akuzuari, është përjashtuar mundësia që nuk kemi të bëjmë me paragrafin 2, të nenit 273 të KPRK-së, por janë përmbushur elemente të paragrafit 1 të veprës penale ***Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së.***

X. Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes së lartësisë së dënimit për të akuzuarin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, duke i shqiptuar dënim si në dispozitiv të Aktgjykimit si rrethanë lehtësuese mori për bazë rrethanen nga koha e kryerjes së veprës penale mars 2013, moshën e tij kryesisht të re në kohën e kryerjes së veprës penale, rrethanat personale të të akuzuarit se tani është i martuar, mbajtës i familjes, prind i një fëmijëve, sjelljen korrekte të akuzuarit gjatë gjithë procesit gjyqësor, ndërsa si rrethana rënduese Gjykata ka marrë se veprat e tilla parqesin rrezikshmëri për shoqërinë, andaj Gjykata në vlerësim të rrethanave të theksuara si më lart i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar me bindjen të plotë se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i këtij dënimi i paraparë sipas nenit 41 KPRK-së, duke pasur efektin në parandalimin e kryesive nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, duke krijuar bindjen skohë e klaurë në masë të parashprehur respektivisht të arresitit shtepiak që nga dt.08.04.2013, deri me dt.05.09.2013, ka pasur efektin e vete në rehabilitimin e të akuzuarit dhe në përmbajtjen e tij që të bëjë ndesh me ligjin, andaj gjykata nga të gjitha këto ka konsideruar se dënimin e shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale për të pandehurin, me rrethanat e konstatuara si më lart.

XI. Dënimin plotësues- konfiskimi i sendit

Gjykata të akuzuarit i ka shqiptuar Dënim plotësues-Marrja e sendit, në mbështetje të nenit 69 par.1 të KPRK-së, duke marrë për bazë se Prokuroria në Aktakuzë në pikën III ka propozuar që të akuzuarit të j'u konfiskohet substanca narkotike. Gjykata në mbështetje të nenit 273 par.5 të KPRK-së ku përcakton se “substancat narkotike, substancat psikotrope ose analoge konfiskohen” e lidhur me neni 282 par.1 ku përcakton se “pasuria që është qenësish e rrezikshme ose e paligjshme i nënshtrohet automatikisht konfiskimit, pa marrë parasysh gjetjet

*e gjyqtarit të vetëm gjykues ose trupit gjykues lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit” lidhur me par.2 nën par.2.4 të KPP-së ku përcakton se “kimikatet, fabrikat, pajisjet laboratorike apo substancat e krijuara apo të përdorura në veprën penale nga neni 272-280 të Kodit Penal”, nga i akuzuari **A.U, ka konfiskuar** substancën narkotike Kanabis (Marihuanë) që përmbanë Tetrahidrokanabinol (THC), me pesh neto 6.92 gram, (sipas Raportit të Ekspertizës së Agjencisë së Kosovës për Forenzikë me nr. ref.AKF/2013-2234/2013-1797, dt.18.07.2013), substancat narkotike pas plotëfuqishmërisësë këtij aktgjykimi të shkatërrohen.*

XII. Lidhur me shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesa pasurore juridike

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e ka marrë në bazë të neneve 450 dhe 451 të KPP-së, ndërsa udhëzimi i palës së dëmtuar për realizmin të kërkesës pasurore juridike në kontest civilo-juridik e mbështeti në nenin 463 të KPP-së.

Gjykata nga arsyet e cekura si më lart duke u bazuar në nenin 365 të KPP-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti për Krime të Renda
P.nr.928/13 dt.07.06.2021**

**Procesmbajtësi
Endrit Hajrizaj**

**Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari
Bekim Veliqi**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.